



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 608/18 prot.

Datë 10.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 498/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 414/2026, datë 24.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “TREG AUTO” SHAME NIPT K01418014P dhe adresë Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Llazar Xhajanka, Godina ne Z.Kadastrale nr.8230, Nr.Pasurie 7/56.

“TOP-OIL” SHA, me NIPT (K16604717F), me adresë: PESHKOPI, Dibër.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

**Subjekte të interesuar:**

Operatori ekonomik "TREG AUTO" SH.A me NIPT K01418014P dhe adresë Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Llazar Xhajanka, Godina ne Z.Kadastrale nr.8230, Nr.Pasurie 7/56.

"ELBA-OIL 2015" SH.A me NIPT L52606201T dhe adresë Xibrake Labinot fushe, Kantjeri midis fshatrave Mirake Xibrake, Elbasan.

"TRONIX" SH.A me NIPT L71821024L dhe adresë Vaqarr, Zona Kadestrale 3712; Tiranë.

"SI & CO COMPANY" SH.P.K me NIPT L21420002F dhe adresë Rruga Qemal Stafa, ndertesa nr.pasurie 3/252- N7, ZK.8140, dyqani D-07, Tirane. 2

"KAPPA – OIL" Sh.A me NIPT J91402501L dhe adresë Xhafzotaj, XHAFZOTAJ, Zona Kadastrale 2547, Durres.

"EXIMOIL" Sh.A me NIPT K91715006E dhe adresë Kashar,Yrshek Njesia Administrative Yrshek,Rruga "7 Nentori", Tirane. Kashar,Lagjia

"AUTO MANOKU" SH.P.K me NIPT K92128001N dhe adresë Njesia Bashkiake nr-7, Rruga e Kavajes, Pallati-152, Hyrja-1, Tirane.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:****I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 24.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 414/2026, ku vendosi:

1. *“Të mos pranojë ankesën e OE “TOP-OIL” SHA, për procedurën e në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
  2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e OE “TREG AUTO” SHA, për procedurën e në procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
  3. *Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “TREG AUTO” SHA sipas konstatimeve të vendimit të mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik.*
  4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
  5. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga OE “TOP-OIL” SHA.*
  6. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHA.*
  7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
  8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 155/15 prot., datë 31.04.2026, protokolluar me tonën nr. 608/10 prot., datë 02.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit për zbatim të vendimit nr.414/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

I.3. Në datën 03.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 471/2026, ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të paraqesë shtojcën e publikuar, në zbatim të vendimit nr. 414/2026 datë 24.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.4. Me shkresën nr. 155/18 prot., datë 07.04.2026, protokolluar me tonën nr. 608/15 prot., datë 09.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka përcjellur rivlerësimin

e procedurës së prokurimit për zbatim të vendimit nr.414/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 155/18 prot., datë 07.04.2026, protokolluar me tonën nr. 608/15 prot., datë 09.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit për zbatim të vendimit nr.414/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi i kryer për zbatim të vendimit nr.414/2026 datë 24.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjensisë së Prokurimit Publik ashtu si dhe nga shkresa e sipërcituar konstatohet se autoriteti ka rivlerësuar procedurën sipas vendimit nr.414/2026 datë 24.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik .

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendosi**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

